



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Unit	SP-02
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	01
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	7807-3/24
Data: Datum: Date.	12.05.25
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	23.04.2025
REFERENC-Ë:	7807/24 - ZSP ; ARPL
PËR/ZA/TO:	„M & SH N’ PIKË „ Sh.p.k. , Rt. „Sheh Emin“ K. Prizren
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, U.D. - Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së; Z. Fatos QERIMI, Drejtori ARPL-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të Drejtën Ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim – Pelqim Ujor ,

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën me nr. të protokollit: 7807/24, nga pala “M & SH N’ PIKË” Sh.p.k. K. Prizren, për kalim mbi pronën ujore, me nr. 11053-2, ZK dhe ka vendosur si në Vendim, për Pëlqim Ujor për kalim me urë, mbi Pronën Ujore, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. P.U.

Datë: 23.04.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjensive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

PELQIM UJOR

APROVOHET kërkesa e palës me „M & Sh N’ PIKË” Sh.p.k., Rr „Sheh Emini „ 1 në K. Prizren, me Nr. prot. 7807/24 për **PËLQIM UJORË**, për kalim mbi pronë ujore me urë:

Nën Kushtet si në vijim:

1. Pëlqimi Ujor lëshohet për kalim të lirë mbi pronën ujore , për çasje në rrugë publike, në pikat me koordinata 1 (X= 7479 081.80; Y=4 677 242.00) dhe 2 (X= 7 479 080.90; Y=4 677 245.43) ;
2. Kalimi mbi pronën ujore, bëhet vetëm për pjesën, respektivisht në gjërësi deri 5.0 m’ dhe jo me teper;
3. Çasja në rrugë, bëhet jasht prones ujore dhe asesi nuk lejohet , shfrytëzimi i së njejtes;

4. Pala duhet të ketë parasysh se, kalimi i lire nuk do të thotë se prona mund të kalojë në pronësi të palës, si dhe duhet të ruaj funksionalitetin, rrumbullqesjen e rrjedhës egzistuese dhe ekosistemin përreth etj;
5. Në pjesën tjetër të pronës ujore, nuk lejohet ndërtim, apo çfarëdo llojë aktiviteti tjetër për shfrytëzim;
6. Pëlqimi vlen vetëm për kalim mbi pronën ujore, ndërsa për kyçje në rrugën publike, duhet të siguroj pëlqim nga organi kompetent për Infrastruktura rrugore.
7. Pala duhet të ketë parasysh, se me rastin e hartimit të Planit të Menagjimit të Resurseve ujore, nëse do të vendoset për kushte tjera, ndryshe nga rasti, duhet të adaptohet atyre, sipas kërkesave të nevojshme, pa ndonjë kompensim;
8. Pëlqimi ujqor ka afatin kohorë prej 2 viteve, nëse deri atëherë nuk e ka filluar ndërtimin.

Arsyetim

Pala ka bërë kërkesë, me nr. prot. 7807/24, lidhur me mundësin e kalimit mbi Pronën Ujqore, me nr. 11053-2, Zona Kadastrale Prizren, për çasje në rrugën Publike nga prona private, Pala kërkesës ia ka bashkangjitur: Vendimin për hartimin e elaboratit dhe studimin e hidrogjeologjik të prones ujore, me kompanin "Prospekt Studio" sh.p.k. nga Prishtina, përrocka ngjitur me parcelat nr. 05112-1; 05112-2; 05112-3; 05112-4 dhe 05112-5.Z.K. Prizren; Pala poashtu ka bashkangjitur diplomën master i shkencave të ndërtimtarisë, drejtimi Hidroteknik, z. Riad Njazi Zejneli; Certifikatën e regjistrimit të biznesit "Prospekt Studio" sh.p.k., Certifikatën e regjistrimit të biznesit "M& Sh. N'pikë " Sh.p.k.; Njoftim për plotësimin e dokumentacionit " ashtu që të prezantohet Pëlqimi nga ARPL-ja –MMPHI-ja për çasje në parcela nga Rruga publike; Certificate e pronesisë private, në emër të pronarit të kompanisë; Kopje Plani për parcelat në Z.K. Prizren përfshirë 5 parcelat; Kontrata mbi ndërtimin përbashkët me kompenzim reciprok LRP.nr.10501/2024; Vertetim i kopjes së dokumentit origjinal; Vendim për leje mjedisore komunale, me nr prot. Nr 05-352-116566, me datë 04.11.2024; Plani i situacionit, punuar me përpjesë të lexueshme 1:1000, hartuar, punuar dhe vulosur nga person i licencuar i lëvizës përkatës, Z Osman Dula, nr i licences 19. Bazuar në pronocimin e drejtorit, duke u bazuar në takimet që kemi pasur dhe informatat faktike që ju kanë ofruar nga unë si zyrtarë përgjegjës, si dhe sqarimin që ka bërë udhëheqësja e DMRU-së, lëndët janë procesuar për nënshkrim, të cilat ishin kthyer, me 01.04.2025 nga ZSP-ja.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr. 7807/24 - ZSP- 2024 Datë: 23.04.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Prizren;
- Arkivit të Ministrisë.

U.d. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së



Izedin BYTYQI